



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN 57/2014, DATË 5.6.2014  
PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT EKONOMIK KOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

Në ligjin 57/2014, datë 5.6.2014, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në të gjithë ligjin termi “Ministria përgjegjëse për ekonominë” zëvendësohet me terim “Ministria përgjegjëse” dhe termi “Ministri përgjegjës për ekonominë” zëvendësohet me termin “Ministri përgjegjës”.

**Neni 2**

Në nenin 9 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1, fjalia e dytë ndryshohet, si vijon: “Organizimi dhe funksionimi i sekretariatit teknik miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave”

Në fjalinë e parë të pikës 4, pas fjalëve “Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar”, shtohen fjalët “, me propozim të Ministrit përgjegjës”.

Në pikën 5, fjalia e parë ndryshohet, si vijon: “Struktura organizative e sekretariatit teknik miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit përgjegjës”.

Pika 6 shfuqizohet.

**Neni 3**

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1, si më poshtë:

“Neni 9/1  
Institucioni përgjegjës

Institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

**Neni 4**  
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.